

AKT NORMATIV
Nr. 4, datë 21.5.2013

**PËR ZHVILLIMIN DHE PJESËMARRJEN E FORCAVE USHTARAKE TË BRITANISË SË
MADHE NË STËRVITJEN E PËRBASHKËT DETARE - AMFIBE “ALBANIAN LION, 2013”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të Britanisë së Madhe në stërvitjen e përbashkët detare - amfibe “Albanian Lion, 2013”, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh.

Neni 2

Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 3000 (tre mijë) trupave ushtarake të Britanisë së Madhe.

Neni 3

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është realizimi i operacioneve të evakuimit joluftarake (NEO-Non-Combatant Evacuation Operations) nëpërmjet detit dhe ajrit, duke përfshirë anije luftarake zbarkuese, helikopterë dhe forca speciale për veprimtaritë në tokë.

Neni 4

Stërvitja zhvillohet në periudhën 10 gusht - 20 shtator 2013, në rajonin e gjirit të Vlorës, gadishullin e Karaburunit, ishullin e Sazanit, bazën e Porto - Palermos, Bizë, Zall - Herr, bazat ajrore të Kuçovës e të Rinasit dhe në Poshnjë, Berat.

Neni 5

Në këtë stërvitje angazhohen 3000 (tre mijë) trupa, 2 (dy) helikoptermbajtës, 2 (dy) anije tip frigatë, 2 (dy) anije zbarkuese, 1 (një) anije civile, 3 (tre) anije të tjera mbështetëse, 2 (dy) avionë ushtarakë dhe 1 (një) avion transporti, të cilët do të kryejnë lëvizje në rajonin e përcaktuar të stërvitjes, sipas nenit 4 të këtij akti normativ. Nga 3000 (tre mijë) trupat britanike, 800 (tetëqind) - 1000 (një mijë) forca do të zbarkojnë në operacione tokësore.

Neni 6

Trupat britanike gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, do të kenë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.10101, datë 26.3.2009.

Neni 7

Gjatë hyrjes, qëndrimit e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, trupat britanike të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe ministri i Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 9

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha